



INFORMATË BAZIKE:

Observeri i Dezinformatave – Monitorimi i Mediave Serbe dhe Ruse është një raport analitik tremujor për lajmet që përmbajnë dezinformata dhe keqinformime që e kanë në shënjestër Kosovën të botuara nga mediat që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi.

PËRKRAHUR NGA:



Londër, Mbretëria e Bashkuar

VËREJTJE:

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë vetëm të Institutit Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED)

KONTAKTI:

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave

Tel: +383 (0)38 542 778

Web-site: www.kipred.org

Email: info@kipred.org

OBSERVERI I DEZINFORMATAVE PËR KOSOVËN


MEDIAT RUSE DHE SERBE
Prill - Qershor 2020

Përmbledhje Ekzekutive


Observeri i Dezinformatave për Kosovën: Monitorimi i Mediave Serbe dhe Ruse është një raport tremujor që synon t'i analizojë trendet dezinformuese të lajmeve të botuara në publikimet e përzgjedhura mediale në gjuhët angleze dhe serbe që origjinën e kanë në Serbi dhe Rusi, dhe që e vejnë në shënjestër Kosovën.

Mediat e përzgjedhura që origjinën e kanë në Serbi dhe që janë të njohura për botimin e lajmeve me përmbajtje dezinformuese janë Tanjug, Informeri, Novosti, Kuriri, B92-shi, Politika dhe Naša Borba, ndërsa mediat e përzgjedhura përkatëse që origjinën e kanë në Rusi janë Russia Today, Sputnik International, Sputnik Serbia, Meduza, Russia Insider, TASS-i, The Moscow Times, Newsfront, Unz, Duran dhe Pravda Report, dhe ky Observer i Dezinformatave për Kosovën po ashtu i analizon edhe dokumentet dhe deklaratat që kanë të bëjnë me Kosovën të botuara nga Kremli dhe nga Ministria Ruse e Punëve të Jashtme.


Monitorimi i të dhënave tregon se që nga 1 prilli deri më 30 qershor 2020, publikimet mediale që origjinën e kanë në Serbi i kanë botuar 1,238 lajme që drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë ndërlidhen me Kosovën. Tanjugu i ka botuar 171, Informeri 162, Novosti 185, B92-shi 486, Kuriri 37, Politika 179 dhe Naša Borba 18 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë të bëjnë me Kosovën.




Trendet dezinformuese të mediave serbe tregojnë se vlera më e lartë në përqindje e raportit lajme/lajme dezinformuese ka qenë në prill 2020, dhe atë 5.47%, e vijuar nga 4.35% në maj, dhe nga 3.32% në qershor 2020.



Monitorimi i të dhënave tregon se nga 1 prilli deri më 30 qershor 2020, publikimet mediale në Rusi kanë botuar 393 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. Sputniku – Botimi në Serbisht, i ka botuar 306, Sputnik International 4, Russia Today 18, Russia Insider 1, Meduza asnjë, TASS-i 19, The Moscow Times 1, Pravda Report asnjë, Newsfront 19, UNZ-i 4, Durani 6, Kremli 1 dhe Ministria e Jashtme e Federatës Ruse 14 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën.



Trendet dezinformuese të mediave ruse tregojnë se përqindja më e lartë e raportit lajme/lajme me dezinformata ka qenë në prill 2020, 12.16%, pasuar nga 12.02% në qershor, ndërsa përqindja më e ulët e këtij raporti ka qenë në maj 2020, 9.01%.



Dekonstruktimi i lajmeve që origjinën e kanë në Serbi dhe që i përmbajnë dezinformatat më flagrante (17 lajme), të botuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e sipërpërmendura të

përzgjedhura, tregon që dezinformimi ka qenë i përqendruar në shkatërrimin e themeleve të legalitetit dhe legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës, përmes:

- Paraqitjes së luftës për pavarësinë e Kosovës si një luftë fetare, dhe të UÇK-së si një formacion ushtarak islamist;
- Vënies në dyshim të të drejtës së Kosovës për ta ushtruar sovranitetin e vet, duke e projektuar atë si një shtet i dështuar, si një shtet që e shtyp dhe që nuk e mbron komunitetin e vet jo-shumicë serb, si një “strofull” e krimit të organizuar dhe e trafikimit, dhe si një qendër për rekrutimin e islamistëve radikalë;
- Mohimit të krimeve të luftës të kryera në Kosovë nga forcat e armatosura serbe gjatë luftës 1998–1999, dhe;
- Diskreditimit të rolit të Perëndimit në shtet-ndërtimin e Kosovës.

Nga ana tjetër, dekonstruktimi i lajmeve që origjinën e kanë patur në Rusi dhe që i kanë përmbajtur dezinformimet më flagrante (13 lajme), të botuara gjatë kësaj periudhe në mediat e përzgjedhura të sipërpërmendura, tregon që dezinformimi ka qenë i përqendruar në rrënimin e themeleve të legjitimitetit dhe legalitetit të shtetësisë së Kosovës përmes:

- Vënies në dyshim të të drejtës së Kosovës për ta ushtruar sovranitetin e vet si jo të ligjshëm dhe në shkelje të së Drejtës Ndërkombëtare;
- Zvogëlimit të rolit të intervenimit dhe përkrahjes ndërkombëtare për Kosovën, dhe paraqitjes së saj si një shtet kriminal, përfshirë edhe përpjekjet e drejtësisë tranzicionale në Kosovë;
- Vënies në dyshim dhe ndryshimit të narrativave për luftën në ish-Jugosllavi, dhe mohimit të krimeve të luftës të Serbisë, dhe;
- Paraqitjes së Kosovës si një shtet që i shtyp komunitetin serb dhe komunitetet e tjera jo-shumicë.


Prandaj, mund të përfundohet që, nga këndvështrimi i përqendrimit të tyre, lajmet me përmbajtje dezinformuese që kanë të bëjnë me Kosovën, që gjatë kësaj periudhe janë botuar nga

mediat që origjinën e kanë në Serbi dhe në Rusi, ishin shumë të ngjashme, nëse jo edhe të njëjta. Synimi i tyre kryesor ka qenë i përqendruar në rrënimin e themeleve të legjitimitetit dhe legalitetit të shtetësisë së Kosovës, duke e paraqitur atë si një shtet i dështuar dhe problematik.

Analizat vijuese do të paraqesin të dhënat statistikore mujore për raportet lajme/lajme me dezinformata për botimet e përzgjedhura mediale me origjinë në Serbi dhe Rusi, dhe këto do të ofrojnë po ashtu edhe analiza të shkurtëra, për përqendrimet dhe synimet e dezinformatave të botuara, bazuar në analizat e dezinformimeve të botimeve të prillit, majit dhe qershorit të vitit 2020 të Lajmëtarëve të Dezinformatave për Kosovën për Mediat Serbe dhe ato Ruse.

Lajmet dhe Dezinformatat Prill 2020


Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga 1 deri më 30 prill të vitit 2020, Tanjugu i ka botuar 35, Informeri 51, Novosti 34, B92-shi 100, Kuriri 7, Politika 43, dhe Naša Borba 4 lajme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kishin të bënin me Kosovën, dhe se 15 nga 274 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kishin përmbajtje dezinformuese.



Dekonstruktimi i lajmeve që i përmbanin dezinformimet më flagrante (5 lajme) të botuara gjatë prillit 2020 tregon se dezinformimi ka qenë i përqendruar në rrënimin e themeleve të legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës duke e paraqitur luftën për pavarësinë e saj si një luftë fetare, dhe UÇK-në si një formacion ushtarak islamik, duke e diskredituar shtetin e Kosovës dhe udhëheqësinë e tij, si dhe institucionet e sigurisë dhe qytetarët e tij, duke ia rrënuar themelet përkrahjes së Perëndimit, dhe duke u përpjekur për ta diskredituar BE-në dhe qëndrimin e saj

ndaj Kosovës. Shumica e artikujve shfrytëzojnë fjalor shpifës dhe përbuzës kur i përmendin shqiptarët dhe elitat politike të Kosovës.¹

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave për mediat ruse tregon se nga 1 deri më 30 prill të vitit 2020, Sputnik Serbia i ka botuar 53, Sputnik International asnjë, Russia Today 2, Russia Insider 1, Meduza asnjë, TASS-i 5, The Moscow Times 1, Pravda Report asnjë, Newsfront 6, UNZ-i 2, Durani 1, Kremli asnjë, dhe Ministria e Jashtme Ruse 3 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kishin të bënin me Kosovën. 9 nga 74 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kishin përmbajtje dezinformuese.




Dekonstruktimi i lajmeve me dezinformata të bëra gjatë prillit 2020 nga mediat e përzgjedhura Ruse dhe Ministria Ruse e Punëve të Jashtme në raport me Kosovën, e tregon përqendrimin e tyre në projektimin e pavarësisë energjetike të Kosovës si një veprim i paligjshëm, në paraqitjen e shtetësisë së Kosovës si një që është e paligjshme dhe në shkelje të së Drejtës Ndërkombëtare, në uljen e rëndësisë së intervenimit dhe përkrahjes ndërkombëtare për Kosovën, dhe në pohimin e gabuar se në kohë të pandemisë COVID-19, BE-ja Kosovën e konsideron si një pjesë të Serbisë.²

¹ Kosovo Disinformation Alert, Serbian Media: April 2020, KIPRED, 2020, [http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - April 2020 \(1\) 357827.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - April 2020 (1) 357827.pdf)

² Kosovo Disinformation Alert, Russian Media: April 2020, KIPRED, 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - April 2020 536416.pdf>

Lajmet dhe Dezinformatat Maj 2020


Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga 1 deri më 31 maj 2020, Tanjugu i ka botuar 55, Informeri 60, Novosti 47, B92-shi 151, Kuriri 13, Politika 62 dhe Naša Borba 3 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. 17 nga 391 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kanë patur përmbajtje dezinformuese.



Dekonstruktimi i lajmeve që i kanë përmbajtur dezinformimet më flagrante (4 lajme) të botuara në maj 2020 tregon se dezinformatat kanë qenë të përqendruara në rrënimin e themeleve të legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës përmes përpjekjeve për delegjitimimin e intervenimit të NATO-s dhe të përkrahjes së vendeve perëndimore, përmes vënies në dyshim të ligjshmërisë së pavarësisë së saj, duke e paraqitur atë si një vend që i shkel të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe si një “çerdhe” e krimit të organizuar dhe e trafikimit.³

³ Kosovo Disinformation Alert, Serbian Media: May 2020, KIPRED, 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - May 2020 36944.pdf>

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave për mediat ruse tregon se nga 1 deri më 31 maj 2020, Sputnik Serbia i ka botuar 96, Sputnik International 1, Russia Today 2, Russia Insider asnjë, Meduza asnjë, TASS-i 3, The Moscow Times asnjë, Pravda Report asnjë, Newsfront 4, UNZ-i 1, Durani 1, Kremli asnjë, dhe Ministria e Jashtme Ruse 2 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. 10 nga 144 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kanë patur përmbajtje dezinformuese.




Dezinformatat e botuara nga burimet e lajmeve ruse, përfshirë Ministrinë Ruse për Punë të Jashtme, synojnë paraqitjen e serbëve të Kosovës si viktime të “terrorit” të ushtruar mbi ta, duke e vënë në pyetje dhe duke i ndryshuar narrativat për luftën në ish-Jugosllavi dhe duke i mohuar krimet e luftës së Serbisë, duke i vënë në dyshim përpjekjet për drejtësi tranzicionale në Kosovë, duke e vënë në pyetje legalitetin e pavarësisë së Kosovës, duke e paraqitur Kosovën si një shtet kriminal, dhe duke e vënë në pyetje rolin e KFOR-it dhe të BE-së në Kosovë.⁴

⁴ Kosovo Disinformation Alert: Russian Media: May 2020, KIPRED, 2020
[http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - May 2020 \(2\) 119310.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - May 2020 (2) 119310.pdf)

Lajmet dhe Dezinformatat Qershor 2020

Monitorimi i të dhënave për mediat serbe tregon se nga 1 deri më 30 qershor 2020, Tanjugu i ka botuar 81, Informeri 51, Novosti 104, B-92-shi 235, Kuriri 17, Politika 74, dhe Naša Borba 11 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. 19 nga 573 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kanë patur përmbajtje dezinformuese.




Dekonstruktimi i lajmeve që i kanë përmbajtur dezinformimet më flagrante (8 lajme) të botuara në qershor 2020 tregon se dezinformatat kanë qenë të përqendruara në diskreditimin e legjitimitetit të shtetësisë së Kosovës, duke e paraqitur atë si një shtet që i shtyp dhe që nuk i mbron komunitetin serb dhe komunitetet e tjera jo-shumicë, si një qendër rekrutuese për islamistët radikalë, dhe duke i mohuar krimet e luftës të Serbisë të kryera në Kosovë.⁵

Nga ana tjetër, monitorimi i të dhënave për mediat ruse tregon se nga 1 deri më 30 qershor 2020, Sputnik Serbia i ka botuar 157, Sputnik International 3, Russia Today 14, Russia Insider asnjë,

⁵ Kosovo Disinformation Alert, Serbian Media: June 2020, KIPRED 2020, http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert Serbian Media - June 2020_656805.pdf

Meduza asnjë, TASS-i 11, The Moscow Times asnjë, Pravda Report asnjë, Newsfront-i 9, UNZ-i 1, Durani 3, Kremli 1 dhe Ministria e Jashtme Ruse 9 lajme, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë patur të bëjnë me Kosovën. 25 nga 208 lajmet e botuara nga këto publikime mediale kanë patur përmbajtje dezinformuese.



Dezinformatat e prodhuara gjatë kësaj periudhe nga mediat e përzgjedhura ruse në raport me Kosovën, kanë qenë të përqendruara në rrënimin e themeleve të legalitetit të shtetësisë së Kosovës dhe të përpjekjeve të NATO-s dhe të Perëndimit për paqe dhe stabilitet në Kosovë, si dhe për shtet-ndërtimin e saj, duke e paraqitur Kosovën si një shtet të dështuar që po ashtu ndërmerr veprime diskriminuese kundër komunitetit serb të Kosovës, duke e mjegulluar të kaluarën përmes mohimit faktik të krimeve dhe mizorive të Serbisë në Kosovë gjatë viteve 90, dhe duke ia rrënuar themelet rolit të SHBA-ve dhe të BE-së në themelimin e Odave të Specializuara të Kosovës.⁶

⁶ Kosovo Disinformation Alert, Russian Media: June 2020, KIPRED 2020, <http://www.kipred.org/repository/docs/D - Alert - Russian Media - June 2020 98629.pdf>